



Buja: Higher-KOS, projekt i rëndësishëm për Kosovën



Artikujt tjerë
Warlick: S'mund të ketë zjedhje lokale të Serbisë në Kosovë
Surro: Bombardimet e NATO-s ndryshuan tërësisht perceptimin e historisë jo vetëm në Kosovë
Feilth: Nuk kam bërë presion ndaj komisionit
Gjendje e pandryshueshme në veti
Përgatitjet për fizibilitet
Tajme të shumta të Ina Ramës me zyrtarë kosovarë
Presidentja Jahjaga priti Albin Kurtin
Buja: Higher-KOS, projekt i rëndësishëm për Kosovën
NDI-ja do të vazhdojë ta përkrahë gratë deputete
EULEX: Përkrahimi në Jatinje është i hapur për mallrat komerciale
Publikuar: 26.03.2012 - 17:55
Prishtinë, 26 mars - Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja ka marrë pjesë në konferencën e cila shënon lansimin e Projektit "Higher-KOS - Promoting Institutional Development in Higher Education and Research in Kosovo" (Higher-KOS- Promovimi i Zhvillimit Institucional në Arsimin e Lartë dhe në Shkencë në Kosovë).

Ministri Buja shprehu kënaqësinë e tij për fillimin e implementimit të këtij projekti që "për ne në Kosovë është shumë i rëndësishëm". Ai falenderoi shtetin austriak për ndihmën që i ka dhënë arsimit në Kosovë për vite me radhë dhe theksoi se dikasteri që udhëheqë ai do të jetë gjithmonë i gatshëm të përkrahë ata që duan të na ndihmojë. Poashtu, ministri theksoi faktin se nga ky projekt do të përfitojnë kryesisht kandidatët për studime të doktoraturës dhe atyre të post-doktoraturës dhe tha se kjo është shumë e rëndësishme për institucionet tona dhe për arsimin në përgjithësi.

"Edhe Ministria e Arsimit e ka shpallur këtë mandat si mandat cilësia, pa pretenduar se këtu përfundon cilësia, por duam të lëmë gjurmë të dukshme në këtë drejtim", u shpreh ministri Buja.

Ministri i Arsimit, pasi që theksoi se "jem i insitues ta realizojmë atë që quhet vlerë", tha se këtë vit janë hapur edhe studimet e doktoratës në Kosovë në 10 fusha studimore dhe në 34 programe.

Edhe rektori i Universitetit të Prishtinës, Mujë Rugova dhe ai i Universitetit të Prizrenit, Mazlum Baraliu theksuan rëndësinë e projektit, ku përfuttes do të jenë arsimi i lartë dhe shkencën.

Ndërsa, Christian Geosits, i cili është edhe përgjegjës për projektin, tha se kjo është një vazhdimësi e aktiviteteve austriake në arsimin e lartë dhe në shkencë. "Jam optimist se arritjet do të jenë të matshme", theksoi ai, ndërsa përmendi se në vitet në vijim, MASHT-i, universitetet publike të Kosovës, Agjencioni i Kosovës për Akreditim, Qendra e NARIC-ut dhe Këshilli Kombëtar i Shkencës do të bashkëpunojnë ngushtë me ekspertët dhe institucionet austriake me qëllim që bashkërisht të rrisin cilësinë në edukim, të promovojnë shkencën dhe të kontribuojnë në ngritjen e kapaciteteve dhe në qeverisje të mirë të institucioneve të përfshira.

Ky Projekt, që do të zgjasë tri vjet, (deri në dhjetor të vitit 2014), do të financohet nga Agjencioni Austriak për Zhvillim, me bashkëfinancim nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës dhe implementohet nga konzorciumi i tri institucioneve partnere: WUS-Austria (World University Service), ZSI (Center for Social Innovation) dhe OeAD (Austrian Exchange Service).


Projekti Higher-KOS, me përkrahjen që do t'u ofrojë institucioneve arsimore të Kosovës, duke ofruar bursa, afro 10 grante për hulumtime shkencore, partneritete programore me universitete austriake, po edhe me ato në rajon, si dhe me shumë veprimtari të tjera, do të kontribuojë në funksionimin sa më të mirë të sistemit të arsimit të lartë në Kosovë, po edhe të atij shkencor në përputhje me vlerat, praktikat dhe standardet evropiane.

Komente (0) Shpërndaje artikullin
Be the first of your friends to like this.
1000 Karaktere

Regjistrohuni për info
Emri Mbiemri
email@company.com

- Të fundit të lexuara Të komentuara
11:35 Tuna planifikon të dashurohet këtë verë
11:26 Eranda Libohova, konkurrenca e re në "Dancing with the Stars"
11:17 Di Maria refuzon kontratën e re të Real Madridit
11:16 Kate Moss e quajll Gwynethin bushitar
11:15 Andy Ræick bafason Roger Federer
11:13 Sezoni i ri në Serie A fillon në 25 qersht
11:11 Chicago dhe Miami pësojnë humbje
11:10 Gotze i gatshëm për derbin ndaj Bayern Munichut
11:07 Mesazhi i John Malkovichit në Ditën e Teatrit
10:38 Boqdanoviq: Nuk tërhiqemi nga zjedhjet në Kosovë
Arkivi Të gjitha lajmet e ditës Dokumentet

Karikatura e ditës



Jeton Mirkulovci Gallery



Në gazetën KOHA Ditore të datës 26.03.2012 mund të lexoni

